# DËSHMI ARKIVI

**A-473273**

VERSIONI 2

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Një histori korruptimi jo dashurimi |
| ADRESA | `https://lapsi.al/blendi-kajsiu-gysi-vlora-nje-histori-korruptimi-jo-dashurimi-i1094564` |
| BURIMI | lapsi.al |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 27 shtator 2026, 09:13:40 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 27 shtator 2026, 09:09:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `7023e7f60a94297baf7ec66235739eeead69db44140846a605d989da984a348f` |
| TEKSTI | `cf7422a8585c8cebbbed26553f7426bd1e175e934f18fafdf952947774a45f29` |
| PAMJA | `0c6b541db2bde5f921fd648c01f076db8eb429e29e2320c084597071937a436a` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `1897c3594e79cb7e551657fa4b96d7598b61c4e2101d0f1e82dd31f3a95c0398` |
| E MËPARSHMJA | `17cea48ceaeca1589e7008c67125059defef15b738f88bdc681aebbd69d175d8` |
| RRËNJA MERKLE | `48d5adc2dc979f83a887c219539e18c9885fc52000dc610804adb08caf975432` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/1897c3594e79cb7e551657fa4b96d7598b61c4e2101d0f1e82dd31f3a95c0398`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Një histori korruptimi jo dashurimi

Fakti që zyrtare të larta të shtetit tonë adhurojnë uritha të tillë si Agasi është dëshmi e korruptimit dhe jo e sensibilitetit romantik. Nivelet e larta të shtetit duhet të shërbejnë si busulla morale dhe parimore për qytetarin e thjeshtë, dhe jo të degradojnë nën nivelin moral të popullatës. Pikërisht kjo është ajo që na trondit në rastin e zonjës Hyseni. Busulla e saj morale dhe parimore ishte nën nivelin e qytetar


BLENDI KAJSIU • 27 SEPTEMBER 2026

Ka një përpjekje, veçanërisht në mediat pro-qeveritare, por jo vetëm, për tu marrë me dimensionin rozë të skandalit të kryetares së SHISH Vlora Hyseni me të pandehurin Ergys Agasi.

Tendenca është produkt sa i interesit mediatik për skupe seksuale edhe i maskilizmit që domionon mediat tona, që femrën e identifikon me emocionin, irracionalitetin dhe dobësinë ndërsa mashkullin me racionalitetin, qëndrueshmërinë dhe forcën.

Nga këtu është e lehtë të kuptosh se përse shumë media dhe analistë janë fiksuar me marrdhënien "dashurore" mes kryetares së SHISH dhe Agasit, apo me paraqitjen e këtij të fundit si zhigolo. Llogjika maskiliste na shpegon së rënia e zonjës Hyseni buroi nga dobësia e saj emocionale, në përputhje të plotë me steriotipet tona shoqërore rreth "dobësisë" së gruas.

Një shpjegim i tillë i shërben shumë edhe pushtetit sepse e zhvendos vëmendjen nga korruptimi tek dashurimi i znj. Hyseni. Pak rëndësi ka në këtë shpjegim fakti që edhe nëse "historia e dashurisë" ka ekzistuar, burimi i saj është paraja dhe pushteti shumë më tepër se ndjenja.

Lexo më tej


23 SHTATOR, 14:39
**Përgjimet ekskluzive/ "O shpirt", "o zemër". Vlora, një spiune që pasioni e çoi drejt krimit**

Është e vështirë të besosh se kryetarja e SHISH do ish dashuruar me Ergys Agasin nëse ai nuk do kish pasur pushtetin, pasurinë dhe lidhjet me botën e krimit që i kish mundësuar marrdhënia me kryeministrin Rama. Këto janë arsyet që shpjegojnë lidhjen e ngushtë të Hysenit me Agasin, pavarësisht nëse ishte shoqërore, seksuale apo platonike.

Ka plot djem më të bukur dhe më të rinj, dhe shumë më të ndershëm, se Ergys Agasi në administratën tonë publike dhe në SHISH që janë nënpunës të thjeshtë, me të cilët Hyseni mund të ish dashurar në mënyrë romantike, edhe pse jo etike apo ligjore, për të plotësuar nevojat e saj njerëzore dhe shpirtërore.

Ama numërohen me gishtat e dorës tipa si Agasi që kontrollojnë dhe vjedhin miliona euro në tendera, që kanë lidhje të fuqishme me botën e krimit dhe që njëkohësisht janë miq të kryeministrit Rama, me të cilin pinë verë të shtrenjtë në zemër të pushtetit. Të gjitha këto fakte, që kryeministri pretendon se nuk i dinte, Vlora Hyseni si kryetare e SHISH i kish të qarta.

Ajo e njihte shumë mirë pasurinë, pushtetin, lidhjet me botën e krimit dhe afërsinë e Agasit me kryeministrin, dhe pikërisht për këtë u lidh me të. Nuk ishte pamja prej urithi

## ide


**Një histori korruptimi jo dashurimi**
Blendi Kajsiu


**Gysi, Bela, Lali, Klodi si maska të një njeriu të vetëm**
Andi Bushati

MOTI TIRANA 21°C
KËMBIMI EURO 91.97

## aktuale

22:06
**Rama niset sot drejt Shqipërisë, mesazh urgjent shqiptareve nga Rinasi direkt pas kthimit**

21:31

Rama mbron projektin nga New Yorku: Zvërneci vlen miliarda, kundërshtarët "sharlatanë"



**TIA dhe Vodafone sjellin teknologjinë Airbus në Tiranë**

Ndiqe Lapsin edhe në

Me interes nga publiku



e Agasit, sharmi i tij intelektual, apo personaliteti i tij elektrizues që e "dashuruan" kryetaren e SHISH. Ishte thjesht pushteti, paraja dhe lidhjet e forta me kryeminsitrin Rama dhe botën e krimit që e transformuan Gysin në një objekt adhurimi.

Lexo më tej



25 SHTATOR, 11:12

**Gysi, Bela, Lali, Klodi si maska të një njeriu të vetëm**

Kjo nuk është një histori dashurie por korruptimi. Tendenca e mediave dhe e analistëve për ta portretizuar Ergys Agasin si një zhigolo romantik fsheh kyçin e suksesit të tij si urithi që hapte kanalet e komunikimit mes pushtetit, krimit dhe korrupsionit. Fakti që zyrtare të larta të shtetit tonë adhurojnë uritha të tillë është dëshmi e korruptimit dhe jo e sensibilitetit romantik.

Ndaj rasti i Vlora Hysenit është sindroma e një administrate publike që popullohet nga banaliteti administrativ dhe politik që ekzistencën njerëzore e ka reduktuar tek adhurimi i pushtetit, parasë dhe i "të fortëve".

Në fakt, bëhet fjalë për një sindromë të gjerë të shoqërisë sonë në përgjithësi që prej kohësh ka vendosur adhurimin e forcës dhe parasë mbi çdo vlerë tjetër, si ndershmëria, kreativiteti apo parimet. Në shumë segmente të shoqërisë sonë, duke përfshirë edhe artin dhe mediat, ekziston adhurimi dhe respekti implicit për modelin e "të fortëve" narkotrafikant që janë pasuruar në mënyrë marramendëse.

Ama është tronditëse të shikosh konsolidimin e këtij fenomeni në majat e shteti shqipëtar që duhet të ishin anti-korpet e tij. Nivelet e larta të shtetit duhet të shërbejnë si busulla morale dhe parimore për qytetarin e thjeshtë, dhe jo të degradojnë nën nivelin moral të popullatës.

Pikërisht kjo është ajo që na trondit në rastin e zonjës Hyseni. Busulla e saj morale dhe parimore ishte nën nivelin e qytetarit të thjeshtë të cilin ajo kish për detyrë ta mbronte dhe ta orientonte.

Adhurimi apo "dashuria" e kryetares së SHISH për një "të fortë" ordiner, një urith të krimit dhe të korrupsionit, për të cilin ajo duket se ka dhunuar parimet themelore të shtetit shqiptar, tregoi se zonja në fjalë e kish humbur tërësisht busullën morale dhe parimore në aktivitetin e saj në krye të SHISH.

Fatkeqësisht është i njëjti fenomen që përsëritet vazhdimisht në çdo skandal të qeverisjes dhe administratës së lartë të kryeministrit Edi Rama. Fytyrën e Vlora Hysenit mund ta zëvendësojmë me atë të Belinda Ballukut, Arben Ahmetaj, Evis Berberi, Erjon Veliajt apo me drejtorët 5D në Bashkinë e Tiranës.

Panteoni i korruptimit në administratën Rama pasurohet çdo ditë me fytyra dhe skandale të reja. Natyrisht që në krye të tij qëndron vetë kryeminsitri që veshi me pushtet, respekt dhe influencë një urith si Ergys Agasi duke e kthyer banalitetin korruptiv në modus operandi të administratës së tij.

Lexo më tej



22 SHTATOR, 14:48

**Rënia e Vlorës në shtratin e krimit**

Në një botë të tillë nuk ka hapësirë për parime, dashuri, romantizëm apo sensibilitet human. Dashuria mund të degjenerojë në korruptim, madje edhe në banalitet. Ama banaliteti dhe korruptimi kurrë nuk prodhojnë dashuri.

Ndaj historia Hyseni – Agasi nuk është një histori rozë mes dy personazheve romatik që sakifikojnë gjithçka për dashurinë alla Romeo dhe Zhuljeta. Është një histori e zezë dhe banale e korruptimit të një zyrtareje të lartë me një person të inkriminuar.




**Saimir Tahiri paralajmëron rikthimin: Do shihemi së shpejti, ka kaq shumë për të thënë**




Rama niset sot drejt Shqipërisë, mesazh urgjent shqiptareve nga Rinasi direkt pas kthimit




Operacion i befasishëm i SPAK, arrestohet në Shkodër Bledar Cafi/ Rishpallet në kërkim Indrit Dokle




"Vlora Hyseni dhe Ergys Agasi u njohën në Kryeministri"

Skenari i saj është shkruar nga Kryeartisti Rama. Ai është autori i vërtetë kësaj historie, sepse të dy protagonistët e saj, Gysi dhe Vlora, janë tërësisht krijesat e tij.

**Shkruar enkas per LAPSI.AL nga Blendi Kajsiu**

## Të këshilluara



### Gysi, Bela, Lali, Klodi si maska të një njeriu të vetëm

Një shpjegim për habinë se si ka mundësi që kryespiunja dhe kryepolicja e vendit i bindeshin verbërisht një zhigoloje anonim



### Rënia e Vlorës në shtratin e krimit

Vlora nuk është as dardhë e as pjeshkë që dikush e ha pas shpinës së kryeministrit. Ajo është ilustrimi më eklatant se si vetë Edi Rama i ka vënë institucionet e vendit në shërbim të pushtetit të tij, që në thelb është pushteti i krimit



### Haga, si përfundim i një epoke të gjatë yes man-izmi



### Gënjeshtra e rezorteve elitare

Në Sazan edhe në Zvërnec qeveria po financon komplekse luksoze banimi që do pasurojnë ndërtues lokal dhe ndërkombëtarë, herë duke i hequr taksat, herë duke i çuar infrastrukturë dhe herë duke privatizuar tokën dhe plazhet publike



### Po tani, a duhet të dorëhiqet Veliaj?

Deri më tani për ta nxjerë Lalin nga burgu u përdor alibia e mos dëmtimit të interesit të qytetarëve dhe punëve të Tiranës. Këtej e tutje, pasi mirë apo keq, Gjykata e Lartë vendosi të lërë edhe për një kohë relativisht të gjatë të izoluar, duhet të jesh i pafytyrë që të mbrosh idenë se ai mund të mbetet kryebashkiak edhe në dëm të këtij interesi



### Ortaku besprerë i Ron Yeffetit

Fabula e përdorimit të sipërmarrëses Arieta Puca, që u promovua nga Rama, për ti hapur rrugën hyrjes në skenë të mikut të tij hebre, përbën realizimin më gjenial të të njëjtit skenar të rilindjes: "Sa më e madhe



përgatitet"



## Insistimi tek krimi, arësyeja përse kryeminstri Rama duhet të dorëhiqet



### Fabula e re e Edi Ramës: Shqiptarëve pasqyrën, për vete milionat

Në sallat mortore të rilindjes, të gjithë e dinë se pallavrat e kryeministrit nuk mund ta ndryshojnë realitetin ku ata e kanë sjellë vendin. Asnjë pasqyrë nuk reflekton dot një Shqipëri tjetër nga ajo që ekziston në të vertetë.



### Blendi Kajsiu: Skandali i vërtetë në rastin Veliaj

Që në momentin e marrjes si i pandehur një standarti politik minimal diktonte dorëheqjen e tij nga detyra në funksion të interesit të Tiranës dhe qytetarëve të saj



### Po sikur Lali të dalë nga burgu?

Një pakt është përvijuar mes kryeministrit dhe kryebashkiakut të burgosur për të kthyer këtë të fundit në zyrë. Po cila do të qe konseguenca për një reformë në drejtësi, që pushtetarët e lartë ia shkëlyen dyert e qelive?

## Me sytë katër



21:35

### "Më shau, e shava"/ Shefi i komisariatit të Krujës flet pas pamjeve të shpullës



PAMJET/ Protestuesit kapin Bledi Çuçin në kafe, bashkëshortja e tij Delina Fico humb durimin

23:13



VIDEO/ Muriqi feston me bluzën e UÇK-së golin ndaj Irlandës

22:44








Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.